

Për/To/Za :	Asamblenë Komunale
Kopje :	Kryesuesit te Kuvendit Komunal z.Fadil Gashi
Nga/From/Od :	Drejtoria për Financa,Ekonomi dhe Zhvillim - z. Aziz Desku
Përmes/Through/Preko :	z. Zenun Elezaj – Kryetar i KK- Klinë
Tema/Subjekt/Subjekat:	Kërkesë për marrje te Vendimit për rialokim te mjeteve në programin e shëndetësisë
Data :	23.08.2021


KËRKESË PËR TRANSFER TE MJETEVE

Transfer i mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale , fondi burimor 10

Nga programi Shëndetësi dhe mirëqenje sociale (730), nga **nen-programi Shërbimet e shëndetësisë primare** (74050), kodi funksional (0721) nga Projekti “Ndërtim i shtëpisë për te moshuar”, kodi i projektit 46931 **shuma prej 15,000.00 € të transferohet:**

Në Programin Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660), nen-programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66395), kodi funksional (0620) në Projektin “**Bashkëfinancim me donatorë**”. Kodi i projektit 48267.

Arsyetim :



Duke qenë se ende nuk ka qenë e mundur të bëhet bartja e pronësisë nga Ndërmarrja shoqërore KBI “Malishgan” në pronësi të komunës së Klinës sipas Vendimit të Qeverisë Nr.05/57 të datës 17 korrik 2018, aktualisht nuk ka kushte për fillimin e procedurave të prokurimit sepse lokacioni ku është dashur të filloj ndërtimi i shtëpisë për të moshuar është pjesë e këtij Vendimi të Qeverisë. Këto prona ende janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të privatizimit dhe për këtë arsye kërkojmë që këto mjete financiare të planifikuara për Projektin “**Ndërtim i shtëpisë për te moshuar**” të transferohen në Projektin “**Bashkëfinancim me donatorë**” ku kemi obligime bashkëfinancimi sipas memorandumeve me Ministrinë e Qeverisë së Kosovës e në veqanti për projektet me bashkëfinancim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për grantin e performancës.